



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1108/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Saranda Bogaj-Sheremeti dhe Dren Rogova, anëtar në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP Bici Com me seli në Podujevë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1613/21, të datës 13.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.07.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit NTP Bici Com me seli në Podujevë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1613/21, i datës 13.04.2022, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1613/21, të datës 13.04.2022, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit NTP Bici me seli në Podujevë. Ndërsa nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, mbetet në fuqi vendimi nr.211/2021 i datës 09.07.2021, i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi NTP Bici Com me seli në Podujevë, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit NTP Bici Com si e bazuar. Të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal Nr. A.nr.1613/21 datë 13.04.2022 si dhe të anulohet vendimi i Divizionit të Ankesave nr. 211/2021 datë 09.07.2021 dhe anulohet vendimi i departamentit të Rimbursimeve dhe Qendrës së Thirrjeve të ATK-së referencë nr.15697 i datës 31.05.2021. Të pranohet kërkesa për rimbursim të mjeteve të TVSH-se në shumë prej 113,446.82€ sipas vendimit përfundimtar të DA-së Nr. 155/2019 i datës 15.07.2019, respektivisht të thyerja e kreditimit (mbi pagesën) të TVSh-së me borxhin tatimor të pashlyer në forme kompensimi debi-kredi konform nenit 41.1 të UA nr.15/2010 ashtu që do të aplikohet kreditimi i TVSh-së në vlerë prej 113,446.82€ për shlyerjen

e detyrimit tatimor aktual të TAI sipas prerjes të gjendjes me datë 15.07.2019 bazuar në Vendimin detyrues të Departamentit të Ankesave të datës 15.07.2019, ose të anulohet Aktgjykimi kontestues i gjykatës të shkallës së parë më nr. A.nr.1613/21 i datës 13.04.2022 si dhe anulohet Vendimi i Divizionit të Ankesave nr. 211/2021 i datës 09.07.2021 dhe rasti kthehet Divizionit të Ankesave për rimbursim të mjeteve të TVSh-së në shumë prej 113,446.82€ sipas vendimit përfundimtar të Departamentit të Ankesave Nr.155/2019 i datës 15.07.2019 i cili është detyrues konform nenit 77.5 të Ligjit Nr.03/L-222.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar nr.211/2021 të datës 09.07.2021 të Administratës Tatimore të Kosovës - Departamenti i Ankesave, nën pikën I të dispozitivit të vendimit është Aprovuar pjesërisht ankesa nr.211/2021 e datës 15.06.2021, e subjektit tatimor NTP Bici Com me numër të regjistrimit biznesor, me NRB:80444923, dhe numër fiskal NRF:600627329, me pronar B.B. dhe me seli të biznesit rr. Godishnjak nr.25-Podujevë, në mbështetje të nenit 132/4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në lidhje me nenin 89 par.2 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Nën pikën II të dispozitivit të vendimit, Aprovohet Kërkesa për Rimbursim të mjeteve për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar e parashtruar brenda gjashtë vitesh nga data e kreditimit të tatimit nga periudha 04/2015-04/2021. Nën pikën III të dispozitivit të vendimit, Refuzohet Kërkesa për Rimbursim të mjeteve për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar e parashtruar mbi periudhën gjashtë vjeçare nga data e pagesës së tatimit nga periudha 2012-04/2015.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e të paditurës Administratës Tatimore të Kosovës – Departamenti i Ankesave, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 19.07.2021, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.211/2021 të datës 09.07.2021, të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e lartcekur. Me arsyetim se gjykata në këtë konflikt administrativ, ka konstatuar se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit, ashtu që ka aprovuar kërkesën për rimbursim të mjeteve për TVSh e parashtruar brenda 6 vitesh nga data e kreditimit të tatimit 04/2015-04/2021 dhe ka refuzuar kërkesën për rimbursim të mjeteve për TVSh e parashtruar mbi 6 vitesh nga data e pagesës së tatimit 2012-04/2015.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me

shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa ai përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Këto pretendime ankimore ky kolegji nuk i aprovoj, sepse vlerësoj se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka konstatuar se duke marrë parasysh datën e paraqitjes së kërkesës për rimbursim TVSh-së të palës paditëse 20.05.2021 për periudhën tatimore 2012-04/2015, gjykata pranon konstatimet se paditësi ka bërë kërkesë për bartje të kreditimit për periudhën tatimore të vlerësimit me tepër se 6 vite që është në kundërshtim me dispozitën e nenit 30 paragrafi 3 i Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe nenit 41 paragrafi 11 i Udhëzimit Administrativ 15/2010 që parashohin: kërkesa për kreditim ose rimbursim për një pagesë të tepërt të çfarëdo lloji të tatimit mund të dorëzohet brenda gjashtë vitesh nga data kur është paguar tatimi. Procedura për aplikim të rimbursimit të tatimit do të rregullohet me akt nënligjor. Kërkesa për rimbursim mund të dorëzohet në çdo kohë pas afatit për dorëzimin e deklaratës së aplikueshme deri në 6 vjet nga data kur është paguar tatimi. Për qëllime të përcaktimit të datës së pagesës së tatimit, pagesat paradhënie të Tatimit në të Ardhura të Korporatave apo Tatimit në të Ardhura Personale do të konsiderohen të jenë paguar në datën kur deklaratat e tilla janë detyruese për t'u dorëzuar në ATK. Paditësi nuk iu ka përmbajtur dispozitave ligjore në fuqi për bartjen e kreditimit në afatin ligjor që nga periudha tatimore kur paditësi ka dorëzuar deklaratën e pagimit të tatimit e që në këtë rast gjykata konstaton e kërkesa për rimbursim e datës 20.05.2021 është paraqit jashtë afatit ligjor nga data kur ka dorëzuar deklaratën e tatimit. Pra, nga kjo gjendje faktike gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur kur e ka pranuar si të bazuar veprimin e të paditurës e cila me të drejtë ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit duke refuzuar kërkesën e paditësit për rimbursim të TVSh-së nga data e kreditimit të tatimit nga periudha 2012-4/2015 të paraqitur jashtë afatit ligjor dhe është konstatuar se provat e administruara nuk dëshmojnë se paditësi ka të drejtën në rimbursim.

Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se vlerësimi i ATK-së, është bazuar në provat në dispozicion dhe dispozitat ligjore të aplikueshme, përkatësisht neni 19.2 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i

kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi i ankimuar është nxjerrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase ka vlerësuar se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1108/22, me datë 06.07.2023

**Kryetar i Kolegjit,  
Ramush Bardiqi**